

Konferenca Ndërkombëtare e Shëndetit Publik në Shqipëri, 12 Maj 2015

Tema e konferencës

Konferenca Ndërkombëtare e Shëndetit Publik, me temë: “*Determinnatët social të Shëndetit*” do të mbahet në datën 12 Maj 2015 në Tiranë, Shqipëri.

Qëllimi i konferencës

Kjo konferencë do të adresojë çështjet kryesore që kanë të bëjnë me determinantët social të shëndetit në kontekstin e tranzicionit shqiptar. Sipas OBSH, determinantët social të shëndetit konsistojnë në faktorë, “*në të cilat njerëzit lindin, rriten, jetojnë, punojnë dhe plaken. Këto rrethana jetësore formësohen nga shpërndarja e parave, pushtetit dhe burimeve në nivel global, kombëtar dhe lokal*”.

Determinantët social të shëndetit reflektohen në pabarazi shëndetësore, të cilat mund të shmangen. Këto pabarazi derivojnë nga kushte të ndryshme sociale dhe ekonomike, të cilat janë të dukshme brenda një shoqërie, apo midis shoqërive të ndryshme. Pabarazitë shëndetësore janë në rritje në vendet ish komuniste në tranzicion në Evropë, duke përfshirë edhe Shqipërinë.

Vendi i konferencës

Hotel Tirana International
Sheshi “Skënderbej” 8, Tiranë, Shqipëri.

Organizimi

Konferenca Ndërkombëtare e Shëndetit Publik organizohet nga Instituti i Shëndetit Publik në Tiranë nën kujdesin e Ministrisë së Shëndetësisë.

Komiteti Shkencor	Komiteti Organizativ	Sekretariati
Arjan Bregu	Gentiana Qirjako	Jonida Canaj
Milva Ekonomi	Rudina Çumashi	Dritan Roshi
Klodian Rjepaj	Albana Ahmeti	Alba Rexha
Genc Burazeri	Jolanda Hyska	
Ali Refatllari		
Mira Rrakacolli		
Eduard Kakarriqi		
Gentiana Qirjako		
Silva Bino		

Ervin Toci
Arben Luzati
Enver Roshi
Jolanda Hyska
Suela Këlliçi
Gazmend Bejtja
Alban Ylli
Edmond Panariti
Edmond Dragoti
Fatlinda Berisha Tahiri
Ulrich Laaser, Gjermani
Helmut Brand, Hollandë
Theodhore Tulchinsky, Israel
Ariel Ahart, USA
Charles Hardy, USA
Patricia Broënell, USA
Izet Masic, Bosnia-Herzegovina
Doncho Donev, Republika e
Maqedonisë
Naser Ramadani, Kosovë
Shaban Mehmeti, Republika e
Maqedonisë

Programi i Konferencës

E Martë, 12 Maj, 2015

08.30 - 09.00	Regjistrimi i pjesëmarrësve dhe Prezantimi i posterave virtual Hapja e sesionit të Konferencës Ndërkombëtare të Shëndetit Publik	
09.00 - 09.45	Mirëseardhje nga Drejtori i Institutit të Shëndetit Publik (ISHP)	Dr. Arjan Bregu
	Fjalë përshëndetëse nga Ministri i Shëndetësisë	Mr. Ilir Beqaj
	Fjalë përshëndetëse nga bashkëpunëtorët ndërkombëtar	Prof. Ulrich Laaser
	Fjalë përshëndetëse nga Koordinatorja e Përherëshme e Kombeve të Bashkuara	Mrs. Zineb Touimi-Benjelloun
	Fjalë përshëndetëse nga Dekani i Fakultetit të Shëndetit Publik, Universiteti Mjekësor i Tiranës	Prof. Enver Roshi

SESIONI PLENAR: Determinantët Social të Shëndetit

Drejtues: Genc Burazeri

09.45 – 10.00	Reformat aktuale shëndetësore në adresimin e determinantëve social dhe pabarazisë shëndetësore në Shqipëri (MSH)	Përfaqësues nga MSH (TBC)
10.00 – 10.15	Evidenca në determinantët social në shëndetësi dhe pabarazitë shëndetësore në Shqipëri	Përfaqësues nga ISHP (TBC)
10.15 – 10.30	Determinatët social në shëndetësi dhe pabarazia shëndetësore në shoqëritë në tranzicion	Përfaqësues nga TPH (TBC)
10.30 – 10.45	Udhërrëfyesit dhe rekomandimet e OBSH në adresimin e determinantëve social në shëndetësi dhe pabarazitë shëndetësore.	Përfaqësues nga OBSH(TBC)
10.45 – 11.15	<i>Pushim kafë dhe prezantim i posterave virtual</i>	
11.15 - 13.00	SESIONI PARALEL 1 Tema: <i>Determinatët social të gjendjes shëndetësore dhe pabarazitë në shëndet</i>	Moderator dhe raportues: ISHP / DSHP Durrës
11.15 - 13.00	SESIONI PARALEL 2 Tema: <i>Mbulimi shëndetësor universal</i>	Moderator dhe raportues: HIF / MSh/ DSHP
11.15 - 13.00	SESIONI PARALEL 3 Tema: <i>Determinantët në përdorimin e shërbimeve shëndetësore</i>	Moderator dhe raportues: TPH / IPH / DSHP Fier dhe Dibër
11.15 - 13.00	SESIONI PARALEL 4 Tema: <i>Ndërveprimi ndërmjet determinantëve mjedisor dhe social në shëndet</i>	Moderator dhe raportues: ISHP

13.00 – 14.30	<i>Dreke dhe prezantim i posterave virtuale</i>	
Sesioni plenar		
14.30 – 15.30	Raportime nga sesionet paralele	
15.30 – 16.00	Fusha të reja kërkimi shkencor dhe rekomandime për politika shëndetësore	Z/Ministër i Shëndetësisë, Drejtor i ISHP, Agjensite e Kombeve të Bashkuara, ekspertë ndërkombëtar
16.00	Përfundime	

Përshkrimi i sesioneve paralele

SESIONI PARALEL 1: *Determinatët social të gjendjes shëndetësore dhe pabarazitë në shëndet:*

Ky sesion do të përfshijë prezantime që kanë të bëjnë me dijet në evidencat aktuale rreth determinantëve të ndryshëm social të cilat afektojnë shëndetin. Këto determinantë social përfshijnë të ardhura të ulëta, edukim arsimor të ulët, papunësi, kushte të varfra jetese, etj. Nivelet e ndryshme sociale në indikatorët shëndetësorë reflektojnë pabarazinë shëndetësore ndërmjet shoqërive të ndryshme. Pabarazitë shëndetësore janë pabarazi që mund të shmangen dhe të papranueshme në shëndet.

SESIONI PARALEL 2: *Mbulimi shëndetësor universal:*

Mbulimi shëndetësor universal nënkupton një sistem shëndetësor ku njerëzit kanë akses ndaj shërbimeve pa pasoja të rënda financiare. Gjithsesi, përveç sistemit të financimit shëndetësor, për të siguruar një mbulim shëndetësor universal në nivele të ndryshme të popullsisë përfshihen edhe aspekte të rëndësishme, të tilla si burime të mjaftueshme shëndetësore, promovimi i efikasitetit të shërbimeve dhe sigurimi i burimeve njerëzore të përshtatshme në sektorin shëndetësor.

Fokusi primar për këtë sesion do të jetë mbi strategjitë në financimin e shërbimeve shëndetësore primare dhe reformat aktuale në Shqipëri, si dhe burimet njerëzore në sektorin shëndetësor në Shqipëri.

SESIONI PARALEL 3: *Determinantët në përdorimin e shërbimeve shëndetësore:*

Fokusi primar për këtë sesion do të jetë mbi disponueshmërinë, aksesin, pranueshmërinë dhe mundësinë e shërbimeve të kujdesit shëndetësor, me një theks të veçantë në mbrojtjen e grupeve vulnerabël dhe të marginalizuar, duke përfshirë minoritetet etnike (komunitetin Rom) si dhe grupet e shtresës së ulët social-ekonomike të cilët vuajnë më shumë.

SESIONI PARALEL 4: *Ndërveprimi ndërmjet determinantëve mjedisor dhe social në shëndet:*

Ky sesion do të adresojë determinatët mjedisorë në shëndet dhe ndërveprimin e tyre me faktorët socio-ekonomik në popullatë. Zakonisht, fatkeqësitë natyrore dhe ndryshimet klimatike ndikojnë më së shumti tek të varfërit; ngjarje të tilla si: tërmete, përmbytje, goditje të temperaturave të nxehta, prekin segmentet e popullsisë me nivel të

ulët socio-ekonomik. Për këtë arsye, në këtë sesion, theksi do t'i vihet ndikimit të ndryshimeve mjedisore dhe determinantëve social në shëndetësi.

Udhëzime për Abstraktet

Abstraktet do të konsiderohen për prezantim me gojë, ose me poster. Prezantimet me gojë do të jenë 10 minuta, dhe 5 minuta kohë për diskutim në sesione 90 minutëshe. Individët duhet të regjistrohen për konferencën me anë të abstrakteve që do paraqiten.

Abstraktet nuk janë të kufizuara vetëm mbi temën e conferences: tema të tjera mbi shëndetin publik dhe shërbimet e shëndetit publik janë të mirëpritura.

Të gjithë abstraktet duhen dorëzuar me email tek: konferencashp@yahoo.com

Afati për dorëzimin e abstrakteve është: 20 Prill 2015.

Aplikantët do të njoftohen për pranimin e abstrakteve të tyre brënda datës 30 Prill 2015.

Udhëzimet e Përgjithshme

- Abstrakti duhet të jetë maksimumi 250 fjalë. Mund të pranohen grafikët, tabelat, ose hartat, por duhet të vendosen në fund të tekstit.
- Autorët duhet të para-përcaktojnë zgjedhjen e parë dhe të dytë të paraqitjes së abstrakteve: me gojë kundrejt prezantimeve me poster.
- Titulli i Abstraktit: duhet të jetë i shkurtër, pa shkurtime dhe iniciale. Vendndodhja gjeografike dhe koha e studimit duhet përmendur kurdoherë e mundur/nevojshme.
- Autori që prezanton: emri i autorit që prezanton duhet të jetë shtypur i plotë (Emër dhe Mbiemër).
- Përfaqësia: nëse keni një ose më shumë përfaqësi, listoni dhe ju lutem përdorni 1, 2, 3 për radhitjen e tyre.

Struktura e Abstrakteve

Autorët duhet të përdorin nën-titujt e mëposhtëm që të strukturojnë abstraktet e tyre:

- *Qëllimi*: duhet të adresojë historikun dhe arsyetimin shkencor për këtë studim, si edhe domethënien e temës nën studim për shëndetin publik. Autorët duhet të përshkruajnë rëndësinë e studimit, pyetj (-a; -et) kërkimore dhe objektivat e studimit.
- *Metodologjia*: duhet të përshkruaj ndërtimin e studimit, vendin (komunitetin, klinikën, spitalin), pjesëmarrësit në studim, rezultatet e matjeve analitike dhe/ose teknikave ndërhyrëse.
- *Rezultatet*: duhet të paraqesin gjetjet kryesore në të dhëna sasiore dhe cilësore, të shoqëruara me intervalet e konfidences ose nivelet e domethënies të testeve statistikore, sipas përshtatshmërisë.

Gjetjet “negative” si edhe “pozitive” mund të jenë me interes të barazvlefshëm. Megjithatë, autorët duhet të raportojnë vetëm ato rezultate në lidhje me konkluzionin.

- *Konkluzioni:* autorët duhet të raportojnë vetëm ato konkluzione që janë të mbështetura drejtpërdrejtë nga të dhënat. Autorët duhet të raportojnë veprimet që rekomandohen të ndërmerren në shëndet publik. Sa të jetë e mundur, autorët duhet të theksojnë madhësinë e ndikimit të punës së tyre kërkimore në shëndet publik.

Procedurat e Vlerësimit

- Të gjitha abstraktet e dorëzuara do të rishikohen nga kolegët e Komitetit Shkencor sipas kriterëve të mëposhtme: (i) risia dhe përkatësia me punën kërkimore; (ii) metodologjia; (iii) ndikimet për kërkimin dhe praktikën e shëndetit publik.

Udhëzimet për regjistrimin

Tarifa e regjistrimit është 2 500 Lekë (për pjesëmarrësit shqiptarë) dhe 20 Euro (për pjesëmarrësit ndërkombëtare). Tarifa për autorët, abstraktet e të cilëve do të pranohen si prezantime orale/poster do të jetë 5000 Lekë dhe 50 Euro, për pjesëmarrësit ndërkombëtarë.

Për t'u regjistruar, ju lutem kontaktoni me sekretariatit e konferencës: konferencashp@yahoo.com